

Vrojtime leksikore

Sa terma përmban FGJSSH i vitit 1980 dhe cila është struktura e tyre?

Mr. Agim Spahiu

28 prill 2008

Përmbledhje

Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe është i tipit të mesëm. Është botuar në Tiranë më 1980, nga një grup autorësh dhe është ribotuar një vit më vonë edhe në Prishtinë nga **Rilindja**. Ky Fjalor ka 41066 fjalë e shprehje fjalësh. Ka edhe një numër të madh termash e shprehjesh terminologjike nga fushat e ndryshme të dijes sonë dhe kjo do të jetë problematika e këtij shkrimi.

Çdokush që e shfleton këtë **Fjalor** sheh se në çdo faqe gjen me qindra terma të fushave të ndryshme. Se sa është numri i tyre, atë askush me saktësi nuk mund ta thotë. Prandaj kjo çështje përherë më ka zgjuar kërshërinë dhe më ka nxitur që t'i qasem kësaj problematike pak më seriozisht. Dhe, pas një analize bukur të thukët kuantitative kam arritur të definoj saktësisht numrin e përgjithëm të termave dhe të shprehjeve terminologjike të fushave të ndryshme në këtë Fjalor, kuptohet, duke u mbështetur në Fjalorin elektronik shpjegues të gjuhës së sotme shqipe, të cilin po jua prezantojmë lexuesve në këtë shkrim.

Për lexuesin e gjerë, që në fillim e shoh të arsyeshme të jap një përkufizim të fjalës **term**, për ta dalluar nga fjalët e leksikut të përgjithshëm. Fjala **TERM** në FGJSSH të vitit 1980 është përkufizuar në këtë mënyrë:

Emërtim i përcaktuar mirë dhe i përpiktë i një nocioni të një fushe të shkencës, të teknikës, të artit, të jetës shoqërore etj., që shprehet me një fjalë ose me një togfjalësh; fjalë ose togfjalësh, që shpreh një nocion të caktuar dhe që përdoret nga një grup i veçantë njerëzish të një profesioni. *Term* shkencor (teknik, ushtarak). *Term* ndërkombëtar. *Termi* filozofisë (i botanikës, i fizikës, i kimisë, i gjuhësisë, i mjekësisë, i muzikës). Përdor *një term*. Kuptimi *i termit*.

Me ndihmën e programeve standarde: grep, sort, uniq, sed, awk etj.,¹ të Unix-it/Linux-it kam arritur t'i sortoj dhe t'i numëroj të gjithë termat e fushave të ndryshme që janë përfshirë në Fjalorin Elektronik të Gjuhës së Sotme Shqipe (1980).

¹Me anë të këtyre programeve është regjistruar dhe përpunuar i tërë korpusin gjuhësor i Fjalorit elek-

Me programet të përmendura, sidomos me **awk**, kam arritur në përfundim se **FGJSSH-i** ka **10955 terma** e shprehje terminologjike nga fushat e ndryshme. Dhe, po të shprehemi në përqindje, del se vetëm terminologjia kap mbi 26 për qind të fjalësit ose një e katërta e tij. Kjo tregon se edhe FGJSSH i vitit 1980 ka shumë elemente të një Fjalori terminologjik. Përfshirja kaq e madhe e termave dhe e shprehjeve terminologjike është një tregues që dëshmon se hartuesit e tij i kanë kushtuar një vend bukur të gjerë terminologjisë.

Të gjithë termat janë fjalë emërtuese, d.m.th., janë emra, mbiemra, folje dhe ndajfolje.

Në këtë **Fjalor** më së shumti kanë zënë vend termat e botanikës me 1756, të pasuar nga ata të zoologjisë me 995, të gjuhësisë me 784, të ushtrisë me 542, të historisë me 480, të mjekësisë me 420, të sportit me 401, të drejtësisë me 382, të anatomisë me 290, të fizikës me 269, e kështu me radhë. Kjo tregon se flora dhe fauna kanë qenë dhe janë shumë të larmishme në Shqipëri e në trevat shqiptare, prandaj edhe emërtimet e tyre, madje edhe ato sinonimike, janë të shumta. Në këtë radhitje nuk janë përfshirë edhe 457 terma specialë që përbëjnë një konglomerat nga fusha të ndryshme.

Në këtë faqe interneti do t' i botojmë disa nga fjalorthët që kanë numër më të madh fjalësh e shprehjesh terminologjike, siç është fusha e botanikës, e zoologjisë, e gjuhësisë, e historisë etj.

tronik. Pastaj, nga kjo më është dashur t' i regjistroj të gjithë termat, duke u mbështetur në shkurtesat, si p. sh. bot., zool., gjuh. hist. etj. Kjo formë e punës më ka hapur rrugë për t' i gjetur të gjitha format e termave, qoftë në formë të një fjale të vetme qoftë në formë togfjalëshi ose edhe me ndonjë strukturë, pak më të rrallë, të fjalisë. Pra, është evidentuar, po e zëmë, edhe termi e thjeshtë njëfjalësh *lule*, por edhe ata që sajohen prej dy e më shumë fjalësh emërtuese si: *lule bore*, *lule argjendi*, *lule mosmëprek*, *lule mosmëharro* etj. Dhe në fund, e tërë kjo procedurë ka rezultuar me numrin e sakët të tyre.




Figura 1: Numri i termave në FGJSSH i shprehur në formë grafikoni